



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE**

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: BO" Kupa" sh.p.k & "Sterkaj" sh.p.k & "LIQENI VII" sh.a & "Arbtrans-2010" sh.p.k

Adresa: Rruga Berisha, Argjinatura me nr.pasurie nr.482, Cerkezë.

Adresa: Njësia Bashkiake nr.5, Blv. Bajram Curri, mbrapa pallateve Agimi, pallati 7/1B, kati 2.

Adresa: Tiranë, Zall Herr Cerkezë - Morinë, Ndërtese 2 katëshe, 100 m larg ish Stallave Çekrezë.

Adresa: Shkozë, L.14.

Lloji i procedurës së prokurimit: "Tender – i Hapur"

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje transmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave"

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-54222-03-12-2020

Fondi limit: 389.607.913 (treqind e tetëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e shtatë mijë e nëntëqind e trembëdhjetë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Afati i kryerjes së punimeve është 4(katër) muaj duke nisur nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 27/04/2020 Ora: 09:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: Çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. BO "Kevin Konstruktion" sh.p.k & "Gjikuria" sh.p.k

K71401004W & J62903456H

Vlera 283,304,087 (dyqind e tetëdhjetë e tre milion e treqind e katër mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

2. BO "Curri" sh.p.k & "Xhengo" sh.p.k & "Agri Konstruktion" sh.p.k

J67902718S & J64103171M & K01725001F

Vlera 296,917,313.6 (dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë presje gjashtë) lekë pa tvsh.

3. BO "Salillari" sh.p.k & "Albstar" sh.p.k & "Shkëlqimi" 07 sh.p.k

J62903125G & J62903512W & K6812808W

Vlera 330,755,681 (treqind e tridhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

4. BO "Kupa" sh.p.k & "Sterkaj" sh.p.k & "LIQENI VII" sh.a & "Arbtrans-2010" sh.p.k

K51615512C & J68310708M & L02325001T & K01730502W

Vlera 381,811,507.02 (treqind e tetëdhjetë e një milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë presje zero dy) lekë pa tvsh.

5. 4 AM sh.p.k K92005016L

Vlera 386,638,269,99 (treqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. BO "Kevin Konstruktion" sh.p.k & "Gjikuria" sh.p.k

K71401004W & J62903456H

Vlera 283,304,087 (dyqind e tetëdhjetë e tre milion e treqind e katër mijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Më datë 08.05.2020 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa BO”Kevin Konstruksion sh.p.k & Gjiguria sh.p.k me lëndë ”Deklaratë tërheqje” prot hyrës 7626,datë 08.05.2020 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi” Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave”

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se **“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”** Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga bashkimi I operatorëve ekonomikë. Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen

2. . BO”Salillari”sh.p.k & “Albstar” sh.p.k & “Shkëlqimi” 07 sh.p.k

J62903125G & J62903512W & K6812808W

Vlera 330,755,681(treqind e tridhjetë milion e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Më datë 08.05.2020 pranë Autoritetit Kontraktor UKT sh.a është protokolluar shkresa e BO”Salillari”sh.p.k & Albstar sh.p.k & Shkëlqimi 07” me lëndë ”Deklaratë tërheqje” prot hyrës 7627,datë 08.05.2020 me anë të së cilën parashtron arsyet e tërheqjes nga procedura me objekt prokurimi” Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave”

Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetet në ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” i cili në nenin 94, “Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës”, pika 1 parashikon se **“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”** Komisioni i

Vlerësimi të Ofertave gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga procedura objekt prokurimi dhe për rrjedhojë të mos shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në sistemin elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë.

Heqja dorë nga oferta e paraqitur nga operatori ekonomik për procedurën objekt prokurimi sjell për rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

3. BO”Curri” sh.p.k & “Xhengo” sh.p.k & ”Agri Konstruksion” sh.p.k

J67902718S & J64103171M & K01725001F

Vlera 296,917,313.6(dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e treqind e trembëdhjetë presje gjashtë)lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 15 si më poshtë vijon:

15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(pese) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	5 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 11(njembedhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatembedhjetë) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	7 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparat për testimin e tubave nën presion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Sharrë asfalti	2copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	5 cope	Pronësi ose me qera
Frezë	2copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues	2 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 250 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) *Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- d) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- e) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- f) *Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohej dhe vendndodhja e mjeteve në pronesi ose me qera me qëllim verifikimi).*

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatoreve ekonomik me nr.128 rep nr. Kol 25 datë 24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive “Curri”sh.p.k&”Xhengo”sh.p.k &Agri Konstruksion sh.p.k.

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit ““Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave»si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k ka marrë përsipër 77%
- Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k ka marrë përsipër 17%.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” sh.p.k ka marrë përsipër 6%

Një ndër operatorët ekonomikë Curri sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e makinerive) se disponon mjetet e mëposhtme:

- Tërheqës me targa AA387HZ për të cilën rezulton të jetë tërheqës. Theksojmë se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kamion dhe jo tërheqës.
- Rimorkio me targa SH4581E për të cilën konstatohet se kapaciteti mbajtës që del nga leja e qarkullimit është 29 ton si dhe rezulton të jetë rimorkio dhe jo mjet kamion siç ka kërkuar AK në DST..
- Mjeti me targa AA145RA me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 10,7 ton.
- Mjeti me targa SH3625 kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9,1 ton
- Mjeti me targa AA653HA kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,2 ton.
- Mjeti me targa AA395OS kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0,91 ton.
- Mjeti me targa AA179OL kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,3 ton.
- Mjeti me targa AA244UC kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,05 ton.
- Mjeti me targa AA485GM kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16,42 ton(mjeti i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 11-17 ton.
- Mjeti me targa AA948UG për të cilën rezulton se operatori ekonomik Curri sh.p.k e ka deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e makinerive)por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion shoqërues çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
- Mjeti me targa AA209RF kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24,4 ton.
- Mjeti me targa AA524YR rezulton se mjeti i paraqitur është kokë dhe jo kamion siç ka kërkuar AK në DST.
- Mjeti me targa AA714XI kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,1 ton.
- Mjeti me targa AA715XI kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,1ton.
- Mjeti me targa AA534XM kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,1ton.
- Rimorkiator me targa ADR334 kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,9ton si dhe lloji i mjetit të paraqitur është rimorkiator dhe kamion siç ka kërkuar AK.
- Gjysëm Rimorkiator me targa AGR993kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 38,4ton si dhe lloji i mjetit të paraqitur është gjysëmrimorkiator dhe kamion siç ka kërkuar AK.
- Mjeti me targa TR7409S për të cilën rezulton se në lejen e qarkullimit është lloji i mjetit APV.Referuar llojit të mjetit të sipërcituar në dispozitat e nenit 54 pika g)të Kodit Rrugor të Shqipërisë shprehimisht citohet se: 1. Automjetet janë mjete me motor me të paktën katër rrota, me përjashtim të autokarrove. Automjetet ndahen në: g) automjet që përdorim të veçantë: mjete të pajisura në mënyrë të

përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Ju bëjme me dije se Autoriteti Kontraktor ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik llojin e mjeteve kamion ndërsa operatori ekonomik Currish.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik llojin e mjetit APV.

Përsa cituam më lart mjeti i paraqitur me targa TR7409S do të konsiderohet i parregullt dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

- Mjeti me targa TR3415R me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,48 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 12.03.2019,) certifikata për te llogari te vet qeradhënësit.
- Mjeti me targa SH2453E me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 23,3 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 09.11.2019) certifikata për llogari te vet qeradhënësit.
- Mjeti me targa AA671RA me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17,65 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 09.11.2019.) certifikata për llogari te vet të qiradhënësit .
 - Mjeti me targa AA210NO me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 04.09.2019 për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 14.01.2020.
 - Mjeti me targa AA213NO me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 04.09.2019 për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 14.01.2020 si dhe polica e sigurimit ka skaduar më datë 27.12.2019.
 - Mjeti me targa AA207NO me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 04.09.2019 për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 18.09.2019 .
 - Mjeti me targa TR2215U me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 15,85 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 04.09.2019 për të cilën rezulton se çertifikata e kontrollit teknik ka skaduar më datë 08.01.2020 si dhe mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
 - Mjeti me targa AA367TF me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 6,64 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
 - Mjeti me targa AA597UJ me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,9 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
 - Mjeti me targa AA935IA me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 7,14 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
 - Mjeti me targa AA739HS me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,8 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se

mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.

- Mjeti me targa AA062OP me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,65 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
- Mjeti me targa AA063OP me kapaciteti të cilës rezulton nga leja e qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,65 ton (mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 25.03.2020 për të cilën rezulton se mungon çertifikata për transport mallrash për të tretë çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit për mjetet me targa përkatësisht mjetit me targa TR3415R me numër çertifikate për transport mallrash nr.254, datë 21.06.2019, mjeti me targa SH2453E me numër çertifikate nr.63, datë 15.04.2019 (vlefshmëria e të cilës ka skaduar më datë 14.04.2020) mjeti me targa AA671RA me numër çertifikate nr.53 datë 15.04.2019 (vlefshmëria e të cilës ka përfunduar më datë 14.04.2020) vëren gjithashtu se çertifikatat janë të lëshuar nga njësi vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak.

Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

- Operatori ekonomik Curri sh.p.k gjithashtu ka deklaruar në shtojcën 10 (mbi disponimin e makinerive) se disponon mjetet me targë si më poshtë cituar:
 - TR6489N, TR0748S, TR1068N, TR5857L si dhe mjetin me targa TR6371P.

Referuar mjeteve të sipërcituara të deklaruara në shtojcën 10 KVO pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik Curri sh.p.k në sistemin elektronik konstaton se operatori ekonomik Curri sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion shoqërues për mjetet e mësipërme çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.

Shoqëria Agri Konstruktion sh.p.k ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtme:

- Kamion me targa TR7967S për të cilën evidentohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion shoqërues çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.
- Kamion me targa TR8514G me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,54 ton (i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve 3,5 ton -5 ton).
- Kamion me targa TR8773S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24,5 ton.
- Kamion me targa TR6120K me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,5 ton.
- Kamionçinë me targa AA173HJ me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton.
- Kamionçinë me targa AA624SN me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1 ton.

- Kamion me targa AA083RG me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 11-17 ton.
- Kamion me targa TR2546S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,3 ton.
- Kamion me targa TR2547S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 24,7 ton.
- Kamion me targa TR2548S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,7 ton.
- Kamion me targa TR2549S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,3 ton.
- Kamion me targa TR9903R me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 25,5 ton.
- Kamion me targa AA168RD me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,85 ton (i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të futet në kategorinë e mjeteve 11 ton -17 ton).
- Kamion me targa KR6072A me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8,2 ton.
- Kamion me targa TR2487S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 12,2 ton mjet i siguruar nëpërmjet kontratës të qerasë datë 20.04.2020.
- Kamion me targa TR6764S me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,1 ton.

Komisioni i Vlerësimit të ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sistemin elektronik për kamionin me targa TR2487S (mjete të siguruar me kontrata qeraje nga operatori ekonomik Agri Konstruksion sh.p.k) vëren se në përmbushje të kushteve të veçanta të kualifikimit të kërkuar në DST operatori ekonomik ka paraqitur leje qarkullimi, çertifikatë e kontrollit teknik, taksë vjetore, foto të mjetit si dhe çertifikatë për transport mallrash për llogari të vet.

Ajo çka konstaton Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është se çertifikata për mjetin e mësipërme përkatësisht mjetin me targa TR248TS me numër 123, datë 11.06.2019 të lëshuar nga njësia vendore për transport mallrash janë cilësuar “Për llogari të vet, pra qeradhënësi e ka për përdorim vetjak. Dhënia e tyre me qera është në kundërshtim me përcaktimet në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, si dhe në nenin 41, të Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 për “Transportet rrugore”, ku parashikohet se: “Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.

Operatori ekonomik Xhengo sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomik ka deklaruar se disponon mjetet e mëposhtme:

- Mjetin me targa 9323B me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 8 ton.
- Mjeti me targa KO9513B me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,2 ton për të cilën evidentohet se mungon foto e mjetit kusht i kërkuar në DST.
- Mjeti me targa KO8308A me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2,5 ton për të cilën evidentohet se mungon foto e mjetit si dhe çertifikata për transport mallrash kusht i kërkuar në DST.

Gjithashtu operatori ekonomik Xhengo sh.p.k ka deklaruar se disponon mjetet me targa AA549KI si dhe mjetin me targa AA021IR për të cilën konstatohet se operatori ekonomik nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion shoqërues çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.

Operatori ekonomik Curri sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë referuar përqindjes të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit për të realizuar kontratën objekt prokurimi duhej të paraqiste 12 mjete të sakta me tonazhin e kërkuar nga AK si dhe me dokumentacionin e kërkuar.

Operatori ekonomik sh.p.k Xhengo sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë referuar përqindjes të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit për të realizuar kontratën objekt prokurimi duhej të paraqiste 2 mjete të sakta me tonazhin e kërkuar nga AK si dhe me dokumentacionin e kërkuar ndërkohë që operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë të tillë.

Sqarojmë se bashkërisht bashkimi i operatorëve ekonomikë plotësojnë vetëm 4 mjete të sakta sipas tonazhit dhe dokumentacionit të kërkuar nga AK nga 16 mjete të kërkuara në DST dhe konkretisht mjetet e konsideruar saktë nga Autoriteti Kontraktor janë mjetet me targë:

AA485GM mjet i paraqitur nga operatori ekonomik Curri sh.p.k si dhe mjetet me targa ,TR8514G,AA083RG,AA168RD mjete të paraqitura nga operatori ekonomik Agri Konstruksion sh.p.k.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. **Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.** Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 15 të shtojcës 12, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatoreve Ekonomik Curri sh.p.k & Xhengo sh.p.k & Agri Konstruksion sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

Së dyti Autoriteti Kontraktor UKT sh.a ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe të figurojnë në listëpagesa për tre muajt e fundit, 1 (një) mjek të përgjithshëm. **Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) mjek të përgjithshëm.**

Mjeku duhet të jetë i siguruar me ditë të plota pune

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit elektronik të paraqitur nga njëri prej anëtarëve ekonomike përkatësisht Xhengo sh.p.k konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për të dëshmuar se disponon 1 mjek ashtu siç është kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" në të cilën citohet se ... **Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.**

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Theksojmë se kriteri i kërkuar nga AK ka qënë i qartë dhe i mirëpërcaktuar dhe për rrjedhojë nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë në përgatitjen e dokumentacionit të tenderit objekt prokurimi.

Operatori ekonomik Xhengo sh.p.k ka pasur momentin procedural për ta kundërshtuar kriterin e sipërcituar.

Përderisa operatori i sipërcituar nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e APP-së atëherë është i detyruar që të plotësojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST në fazën e vlerësimit të procedurës të prokurimit.

Gjithashtu sqarojmë se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kriteret e kualifikimit të përcaktuara në DST.

Përsa cituam më lart mungesa e dokumentacionit nga njëri prej bashkimit të operatorëve ekonomikë përkatësisht Xhengo sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Në përmbushje të kriterit të kërkuar nga Autoriteti Kontraktor një nga operatorët ekonomikë përkatësisht Agri Konstruksion pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik si mjeke të shoqërisë z.L.K.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit mbi disponimin e mjekut në sistemin elektronik operatori ekonomik Agri Konstruksion sh.p.k ka paraqitur kontratë pune datë 01.04.2019 e nënshkruar me z.L.K, librezë pune, CV, liçensën e mjekes e cila mban datën 06.01.2015.

Bëjmë me dije se liçensat e mjekut janë të vlefshme vetëm për një periudhë 5 vjeçare.

Duke qënë se liçensa për mjeken L.K mban datën 06.01.2015 lehtësisht vërtetohet se kjo liçensë nuk është më e vlefshme.

Përsa cituam më lart dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik përkatësisht Agri Konstruksion sh.p.k do të konsiderohet i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm

Së treti AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

9. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi

profesional nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 6 (gjashtë) specialist për montim tubash
- 4 (katër) hidraulik
- 3 (tre) saldator

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune
Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatoreve ekonomik me nr.128 rep nr. Kol 25 datë 24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive “Curri”sh.p.k&”Xhengo”sh.p.k &Agri Konstruksion sh.p.k.

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave»si dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k ka marrë përsipër 77%
- Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k ka marrë përsipër 17%.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” sh.p.k ka marrë përsipër 6%

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave» në të cilën evidentohet se operatori ekonomik Xhengo sh.p.k ka marrë përsipër të realizojë punime në kapitullin «Linja e transmetimit në qytetin e nxënësve përkatësisht zërat nr.14-27 duhej të paraqiste specialist montim tubash, saldator, hidraulik.

Gjithashtu operatori ekonomik Xhengo sh.p.k pjesë e bashkimit të operatorëve ekonomikë ka marrë përsipër gjithashtu zërat e punimeve në kapitullin »Nyja e bashkimit të Tubit 711,2mm me Tubin 630mm»nr.1-nr.6,zërat e punimeve në kapitullin»Nyja e Lidhjes në pusetën e pikës Marrjes» përkatësisht zërat nga nr.1 -14 si dhe zërat e punimeve në kapitullin «Linja e Transmetimit Katund i Ri»përkatësisht zërat nga nr.15 deri në zërin nr.28 si dhe në nëndarjen «Puseta e Lidhjes»për të cilët vërehet se ka marrë përsipër të realizojë punimet nga zëri nr.1 deri në zërin 13.

Referuar natyrës të punimeve të marra përsipër nga operatori ekonomik «Xhengo»sh.p.k duhej të paraqiste specialistë montim tubash ,hidraulik,saldator të pajisur me dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në pikën 9 të DST.

Në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Xhengo”sh.p.k evidentohet se operatori ekonomik Xhengo sh.p.k nuk ka arritur të paraqesë asnjë specialist të kërkuar në pikën 9 të DST përkatësisht hidraulik,saldator,specialist montim tubash.KVO gjykon se është pikërisht natyra e punimeve që do të realizohen nga shoqëria “Xhengo” sh.p.k të cilat kërkojnë që shoqëria të disponojë staf teknik për realizimin e kontratës si specialist montim tubash,saldator,hidraulik të pajisur me dëshmi profesionale ashtu siç është kërkuar në pikën 9 të DST.

Gjithashtu KVO edhe nëse i referohet të përqindjes të marrë përsipër në kontratën bashkepunimit(përkatësisht 17%) Xhengo duhej të paraqiste të paktën 2 specialistë të kërkuar në pikën 9 të DST.Ne rregullat e prokurimit theksohet se , operatorët janë të detyruar të përparojnë ofertat dhe **paraqesin të plote të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DT** .Mopletesimi qofte edhe i nje kriteri te vetem perben shkak per skualifikim.

Në shtojcën 12 shprehimisht parashikohet se....**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim**

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga njëri prej anëtarëve “Xhengo” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket stafit mbeshtetes për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Theksojmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Pra, sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga njëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomik Xhengo sh.p.k lidhur me pikën 9 të DST është i paplotë dhe për rrjedhojë i pavlefshëm.

Së katërti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar:

7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 28 (njetete e tetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten:

- Grupi I- 8(tetë) punonjës
- Grupi II-11(njembëdhjete) punonjës
- Grupi III- 5(pesë) punonjës
- Grupi IV- 2 (dy) punonjës
- Grupi V- 2 (dy) punonjës

Punonjësit e sipërcituar duhet të jenë të siguruar me ditë të plota pune.

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme)

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ka paraqitur si më poshtë cituar:

Akt-Marreveshje për bashkimin e operatoreve ekonomik me nr.128 rep nr. Kol 25 datë 24.04.2020 e nënshkruar ndërmjet shoqërive “Curri”sh.p.k&”Xhengo”sh.p.k &Agri Konstruksion sh.p.k.

Ku palët kanë renë dakort që detyrat për realizimin e objektit “ Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në

depon Qytet Nxënsave»dhe ndarja e fitimit sipas pjesëmarrjes do të jetë si më poshtë cituar:

- Operatori ekonomik “Curri” sh.p.k ka marrë përsipër 77%
- Operatori ekonomik “Xhengo” sh.p.k ka marrë përsipër 17%.
- Operatori ekonomik “Agri Konstruksion” sh.p.k ka marrë përsipër 6%

Njëri nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës Xhengo sh.p.k në përmbushje të kriterit të mësipërm operatori ekonomik Xhengo sh.p.k ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacion kontratë pune të nënshkruar me punonjësin z.E.Jonusllari shoqëruar me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik(IQT)me profesion manovrator kategoria e parë.

Referuar përqindjes të marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit rezulton se anëtari i këtij bashkimi “Xhengo ” duhej të dispononte 4 punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose institucione ekuivalente.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik operatori i sipërcituar ka paraqitur vetëm 1(një)punonjës me dëshmi të kualifikimit të sigurimit teknik.

Citojmë se ndarja në përqindje e kontributit dhe në terma konkretë të punëve për secilin anëtar të bashkimit nëpërmjet aktmarrëveshjes bëhet pikërisht në funksion të përmbushjes së kriterëve në atë masë apo në proporcion me atë që operatori ekonomik ka marrë përsipër të kryejë për realizimin me sukses të kontratës.

Në këtë kuptim Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga njëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë “ Xhengo” sh.p.k nuk është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Së pesti AK ka kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit/kapaciteti teknik pika 17 si më poshtë cituar:

17.Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Kontrate furnizimi ne prani te noterit me furnizuesin e tubave qe do te vendosen ne objekt, i shoqeruar me certifikate ISO 9001:2015 te prodhuesit te mallit dhe katalogjet teknike te mallit të kerkuar. Në rast se katalogjet apo broshurat janë në gjuhë të huaj atëherë duhet të paraqiten të përkthyer, te noterizuara sipas legjislacionit ne fuqi .

Në përmbushje të kriterit të kërkuar nga AK bashkimi i operatorëve ekonomikë kanë paraqitur në sistemin elektronik kontratë furnizimi noteriale datë 24.04.2020 nr.rep 127, nr.kol 24 nënshkruar midis palëve nën cilësinë e furnizuesit “ Konti Hidroplast DOOEL”person juridik i regjistruar në Republikën e Maqedonisë”si dhe palë porositëse Curri sh.p.k &Xhengo sh.p.k.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vëren se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion shoqërues çertifikatë e prodhuesit 9001:2015 si dhe katalogje teknike të prodhuesit “Konti Hidroplast DOOEL”

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të mësipërm KVO konstaton se katalogjet teknike si dhe çertifikata e prodhuesit Konti Hidroplast DOOEL rezultojnë të jenë në gjuhë të huaj përkatësisht në gjuhën maqedonase dhe angleze.

Referuar nenit 14 të VKM nr,914 datë 29.12.2014”Për Prokurimin Publik parashikohet shprehimisht: **“Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe”. Në dokumentat e tenderit, Seksioni IV Procedura, pika IV.6 është përcaktuar shprehimisht: “Gjuha (-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip X Anglisht Tjetër.**

Gjithashtu në kriteret e përgjithshme të kualifikimit shtojca 12 citohet se**Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me**

një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Sqarojmë se në kriterin e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor UKT sh.a në DST shprehimisht është cituar se katalogjet teknike si dhe çertifikata e prodhuesit duhet të paraqiteshin të përkthyer dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Theksojmë se kriteri i kërkuar është i qartë dhe pra nuk lë vend për paqartësi për operatorët ekonomikë pjesëmarrës në përgatitjen e dokumentacionit të kërkuar.

Përderisa bashkimi i operatorëve ekonomikë nuk e kanë ushtruar të drejtën e ankimit brenda 7 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës në faqen e APP-së mbi kriteret e përcaktuara nga AK atëherë është i detyruar që të plotësojë të gjithë dokumentacionin e kërkuar në DST në fazën e vlerësimit të procedurës të prokurimit.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55 /2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" në të cilën citohet se ...Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

4. AM sh.p.k

K92005016L

Vlera 386,638,269,99 (treqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e nëntë presje nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Së pari AK ka kërkuar në kriteret e veçanta të kualifikimit kapaciteti teknik pika 15 si më poshtë vijon:

15. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(pese) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	5 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir	2 cope	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 11(njembedhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatembedhjetë) ton për secilin kamion	6 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Mini eskavator	2 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	7 copë	Pronësi ose me qera
Makine për ngjitje tubash PE	2 copë	Pronësi ose me qera
Aparat për testimin e tubave nën presion	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Sharrë asfalti	2copë	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy)	5 cope	Pronësi ose me qera

ton për secilin kamionçinë		
Frezë	2copë	Pronësi ose me qera
Rrul vibrues	2 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 250 copë
- Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

g) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Çertifikatë për transport mallrash për llogari të vetë dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme) Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontraten perkatese të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jënë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.

h) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

i) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.

j) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

k) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).

l) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi).

Në përmbushje të kriterit të kërkuar në DST operatori ekonomik 4 AM sh.p.k ka deklaruar në shtojcën 10(mbi disponimin e mjeteve) si më poshtë cituar:

-Mjeti me targa AA524UH kapaciteti I të cilës rezulton nga leja e qarkullimit 2,8 ton.

-Mjeti me targa AA694DK kapaciteti I të cilës rezulton nga leja e qarkullimit 3,1 ton.

-Mjeti me targa AA361RE me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3,7 ton (mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 3,5 -5 ton).

-Mjeti me targa AA234RV me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0,65 ton.

-Mjeti me targa AA367NS me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për

këtë mjet 2,2 ton.

-Mjeti me targa AA604SB me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,2 ton(mjet i cili do të konsiderohet I rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve min 11 ton -17 ton.)

-Mjeti me targa AA987XI me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 16,8 ton për të cilën evidentohet se operatori ekonomik 4AM sh.p.k nuk ka paraqitur certifikatë për transport mallrash çka bie në kundërshtim me kushtet e veçanta të kualifikimit.

-Mjeti me targa AA605SB me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 15,4 ton mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 11-17 ton.

-Mjeti me targa AA892TT me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 22,6 ton.

-Mjeti me targa AA639NX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 28,7 ton.

-Mjeti me targa AA641NX me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 28,7 ton.

-Mjeti me targa AA465PC me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 11,2 ton(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 11-17 ton.

-Mjeti me targa AA469PC me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 4,9 ton(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 3,5-5 ton.

-Mjeti me targa AA882PM me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 2 ton(mjet i cili do të konsiderohet i rregullt dhe do të klasifikohet në kategorinë e mjeteve 1,5-2 ton.

-Mjeti me targa AA598ZI me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,1 ton.

-Mjeti me targa AA133RY me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,12 ton.

-Mjeti me targa AA053XC me kapacitet mbajtës i cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1,4 ton.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 5 mjeteve me kapacitet mbajtës min 3,5 ton dhe max 5 ton pasi ka paraqitur vetëm 2 mjete të saktë sipas kapacitetit dhe dokumentacionin të kërkuar nga AK.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 6 mjeteve me kapacitet mbajtës min 11 ton dhe max 12 ton pasi ka paraqitur vetëm 3 mjete të saktë sipas kapacitetit dhe dokumentacionin të kërkuar nga AK.

Sa më sipër cituar operatori ekonomik nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për:

- Paraqitjen e 5 mjeteve me kapacitet mbajtës min 1,5 - 2 ton pasi ka paraqitur vetëm 1 mjete të

saktë sipas kapacitetit dhe dokumentacionin të kërkuar nga AK.

Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. **Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.**

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, vlerësojmë se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 15 të shtojcës 12, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit, nuk mund të konsiderohet i përmbushur.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik . " 4 AM "shpk " është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve te kerkuar Kamion me kapacitet mbajtës 11-17 ton,kamion min 1,5 ton-2 ton mjete të nevojshme për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:*Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë, BO" Kupa" sh.p.k &"Sterkaj" sh.p.k &"LIQENI VII" sh.a &"Arbtrans-2010" sh.p.k me vlerë oferte 381,811,507.02(treqind e tetëdhjetë e një milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatë presje zero dy)lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë Rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, me nr tel: +355 4 2225572, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vijohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12.05.2020**

Ankesa: PO

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit

63 pika 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, UKT sh.a është paraqitur Formulari i Ankesës nga BO”**Curri sh.p.k & Xhengo sh.p.k & “Agri Konstruksion” sh.p.k** hyrë në UKT sh.a me shkresën Nr. Prot. datë 19.05.2020. (administruar në dosjen e prokurimit) në lidhje me vlerësimin për procedurën e prokurimit me objekt: “ Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Katund, Katund i Ri: Ndërtim linje trasmetimi nga puseta Yzberisht deri në depon Qytet Nxënsave”

Me marrjen e ankesës nga Bashkimi i operatorëve ekonomikë të mësipërm, në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me Urdhërin me Nr. 6068/5 Prot. dt.19.05.2020 Prot., është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” me Urdhërin me Nr. 6092/4 Prot. dt. 13.05.2020 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi ka shqyrtuar ankesën e BOE, ka konkluduar sa më poshtë: Nuk janë marrë parasysh pretendimet e ngritura nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë të mësipërm dhe është konsideruar i drejtë dhe i bazuar në ligj, Vendimi i Komisionit të Vleresimit të Ofertave.

Ky konkluzion i është rekomanduar Titullarit të Autoritetit Kontraktor si dhe është vënë në dijeni Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “”**Curri sh.p.k & Xhengo sh.p.k & “Agri Konstruksion” sh.p.k**“ me ane të shkresës Nr. K-8195/1 datë 22.05.2020 (administruar në dosjen e prokurimit).

Gjatë ezuarimit të afateve të ankimimit operatori ekonomik nuk ka ushtruar të drejtën e ankimimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Më datë 03.06.2020 AK si rezultat i përfundimit të afateve të ankimimit çpezulloi procedurën objekt ankimimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **12.05.2020**